



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 26 maj 2026, në mbledhjen e V-të (pesë) -e rregullt, mandati VIII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:05.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Isak Shabani, Haki Rudari, Artrit Mulliqi, Adelinë Stublla, Qëndresë Hajrizi, Alisa Jetullahu, Ekrem Rrahmani, Mimoza Abdullahu), ndërsa mungoi Enis Shabani. Lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin; z.Fahri Restelica Nënkryetar i Komunës, Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ; Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH; Lirie Hoti Rama, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS;

Rendi i ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, kemi 4 pika të rendit të ditës

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 22.04.2026.
2. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0006427/26 i datës 29.01.2026 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete- Shkresa e MAPL-së nr.020-92/6 e datë 23.04.2026.
3. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale -DHSMS.
4. Informatë nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ.

Këto dy pikat e fundit janë në bazë të planit të punës për të cilat i kanë sjell materialet dy drejtoritë përkatëse, andaj nëse ddikush dëshiron ta marrë fjalën rreth rendit të ditës para votimit të këtij rendi të ditës.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, theksoi, kemi një propozim për një zëvendësim të një anëtari të një komisioni sepse kemi një kërkesë nga ana e znj.Nazife Gashi, që të mos jetë anëtare e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Njësia kadastrale; Lokali afarist me sipërfaqe 50m², dhe Lokali afarist me sipërfaqe 55m² të ndërtuara në Njësinë kadastrale P-71712062-00459-0 me sipërfaqe 2237m², Zona Kadastrale Podujevë. Kjo kërkesë është bë më datë 01.04.2026, por për shkak të ligjshmërisë që janë vonuar nga ana e ministrisë për vendime të kuvendit është dashur ta shtyjme këtë deri në këtë seancë, ne si drejtori kemi bë prapë thirrje publike për aplikim për me bë zëvendësimin e këtij anëtari të komisionit mirëpo gjatë kontrollimit të emailit zyrtar kemi pa që është një aplikim nga një ojq. Është një anëtar i një OJQ-je që ka aplikuar e ai është z.Shqipdon Rushiti dhe nga ana juaj kërkoj që ta përkrahni këtë propozim.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, theksoi, dje e kemi mbajtur mbledhjen e KKSBS-së, në këtë mbledhje është miratuar plani i punës apo kalendari i aktiviteteve për vitin 2026. Për shkak se jemi pak me vonesë sepse udhëzimi administrativ parasheh që të mbahen 3 mbledhje të KKSBS-së, brenda 6 mujorit të parë unë sot paraqes para jush dhe kërkoj që të rekomandohet për mbledhjen e radhës që të futet në rend dite edhe plani i punës së këshillit për siguri në bashkësi (KKSBS-së), pasi që kërkon edhe miratimin e kuvendit ky plan përveç se është miratuar në KKSBS. Unë këtu i kam materialet besoi që sekretaria do t'ua shpërndaj kalendarin e aktiviteteve dhe kërkoj nga ju që të rekomandohet për mbledhjen e radhës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë vetëm dua një sqarim nga drejtori rreth këtij propozimi që e bëri sepse në faqe të komunës pash mbledhjen e KKSBS-së, por sa pashë unë aty s'ka pas as kuorum, a ka mundësi të na e tregoni listën e pjesëmarrësve të asaj mbledhje se sa pash unë në atë mbledhje ishin vetëm 7 ose 8 persona shpresoj të jem gabim por aty pat njerëz të tjerë që s'janë anëtarë të KKSBS-së. Nëse s'ka pas kuorum dhe kenë miratuar planin e punës dua ta dinë arsyen pse aq shumë u turrsi të jeni pjesë e KKSBS-së e tash të mungoni dua ta di arsyen a si kanë pa emailt apo s'janë njoftuar se pash një pjesëmarrje aq të zbehtë.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSH, theksoi, sigurisht se rregullat dhe udhëzimet e parashohin që mbledhja nuk mbahet fare pa kuorum, në mbledhjen e djeshme ka pas kuorum të mjaftueshëm sepse fillimisht është konstatuar kuorumi për fillimin e mbledhjes, ka pas mungesa, e di sipas informimit që është bërë përfaqësuesi i FSK-së me kohë ka lajmëruar që s'do të marrë pjesë në këtë mbledhje mirëpo kuorumi ka qenë i mjaftueshëm. Sa i përket nënshkrimeve unë e di që në këtë rast zyra ligjore i ka nënshkrimet dhe besoi që mundet me ua paraqit nëse është e nevojshme por me thënë realitetin asnjë mbledhje nuk fillon e as nuk mbahet pa pas kuorum të mjaftueshëm.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, tani e vë në votim propozimin e paraqitur nga U.D. drejtoresha e DPKGJ që në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje të përfshihet si pikë shtesë edhe propozim vendim për ndryshim plotësimin e vendimit nr.prot.01-020/04-0019212/26 të datës 31.03.2026, Për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Njësia kadastrale; Lokali afarist me sipërfaqe 50m², dhe Lokali afarist me sipërfaqe 55m² të ndërtuara në Njësinë kadastrale P-71712062-00459-0 me sipërfaqe 2237m², Zona Kadastrale Podujevë.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësieri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent, mbështetet propozimi i paraqitur nga U.D. drejtoresha e DPKGJ që në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje të përfshihet si pikë shtesë edhe:

- ***Propozim vendim për ndryshim plotësimin e vendimit nr.prot.01-020/04-0019212/26 të datës 31.03.2026, Për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Njësia kadastrale; Lokali afarist me sipërfaqe 50m², dhe Lokali afarist me sipërfaqe 55m² të ndërtuara në Njësinë kadastrale P-71712062-00459-0 me sipërfaqe 2237m², Zona Kadastrale Podujevë.***

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, tani e vë në votim propozimin e paraqitur nga U.D. drejtori i DSHPMSH që në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje të përfshihet si pikë shtesë edhe Propozim plani i punës së KKSBS-së për vitin 2026

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësieri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent, mbështetet propozimi i paraqitur nga U.D. drejtori i DSHPMSH që në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje të përfshihet si pikë shtesë edhe:

- Propozim plani i punës së KKSBB-së për vitin 2026

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, tani pa humbur kohë më shumë e vë në votim miratimin e rendit të propozuar të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe dy propozimet / pikat shtesë të propozuara dhe mbështetura paraprakisht sipas materialit përkatës të prezantuar në hyrje të kësaj mbledhje

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe dy propozimet / pikat shtesë të propozuara dhe mbështetura paraprakisht sipas materialit përkatës të prezantuar në hyrje të kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 22.04.2026

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, lidhur me procesverbalin a dëshiron dikush ta merre fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim miratimin e Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 22.04.2026

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent, miratohet pa ndryshim plotësim apo vërejtje eventuale procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 22.04.2026, sipas materialit përkatës të dërguar.

2. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0006427/26 i datës 29.01.2026 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete

- Shkresa e MAPL-së nr.020-92/6 e datë 23.04.2026.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nga ministria e pushtetit lokal është konstatuar që Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0006427/26 i datës 29.01.2026 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi prandaj e kemi kthyer në rishqyrtim dhe ne e kemi obligim që ta rishqyrtojmë në mbledhjen e radhës së kuvendit.

z.Haki Rudari, theksoi, ne si grup e përkrahim kërkesën nga MAPL-ja për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0006427/26 i datës 29.01.2026 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete. Konsiderojmë që para se të merren vendimet e kuvendit komunal secila drejtori, secili këshilltar, secili anëtar i kuvendit komunal duhet për çdo vendim ta di a është në kundërshtim me ligjin ose jo. Dëshirat e njerëzve janë dëshira që duhet me i lënë jashtë seancave të kuvendit për arsye se kuvendi është një organ i paraparë me ligj ku zgjidhen anëtarët e tij nga votat e qytetarëve dhe në këtë drejtim duhet secili të punoj dhe të veprojë e të votojë jo në bazë të dëshirave dhe intervenimeve të ndryshme por në bazë të asaj se si e parashihet ligji. Ne si grup e përkrahim këtë rishqyrtim dhe natyrisht i rekomandojmë kuvendit për shqyrtim dhe marrjen e një vendimi konform ligjit dhe rregullores.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, besoj që për këtë pikë duhet me marrë fjalën ti kryesues së bashku me zyrën ligjore, nëse kthehesh dhe e lexon procesverbalin çka të kam thënë në atë mbledhje, ku kam kërkuar tri herë nga pesë minuta pauzë se ligji për vetëqeverisjen lokale të tregon saktë qysh duhet të ndahen këto vende. Në njëfarë mënyre kuvendi nuk është i kompletuar pa komitete edhe pse thuaj ne jemi tani në muajin e gjashtë dhe nëse i referohemi shkresës së MAPL-së aty thuhet që brenda 30 ditëve duhet të bëhet

rishqyrtimi dhe shkresën e ke pranuar më datë 23 prill ndërsa seanca është thirr më datë 28 maj, a po bën shkelje prapë sepse ka kaluar afati prej 30 ditëve e seanca është dashur të thirret para datës 23 maj për mos me bë shkelje të njëpasnjëshme. Unë besoj që MAPL-ja e ka cek shumë mirë dhe unë e kam pas nijet ta dërgoj shkresën në gjykatën administrative dhe tash nuk ka më me të njohshëm të kthehen vendimet dhe kur të shkelen këtu rregullat dhe ligjet , ligji tregon saktë si bëhet ndarja e anëtarëve e jo një anëtarë të jetë në komitet e 13 anëtarë këtu të kuvendit asnjëri prej tyre mos të ketë të drejtë të jetë anëtar i komitetit e kjo është shumë pa lidhje, besoj që pas kësaj shkrese të MAPL-së kjo është e gatshme dhe vlen për të ardhmen dhe dihet saktë ndarja e këtyre vendeve andaj besoi që do të kaloi kjo.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e vë në votim që kuvendit t'i rekomandohet për shqyrtim propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri, me 8 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Informatë nga Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DHSMS

znj.Lirie Hoti Rama, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; e paraqiti Informatën në fjalë, theksoi, sipas planit të punës për vitin 2026, të kuvendit komunal e kemi të planifikuar për këtë muaj Informatë nga Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kështu që rekomandoj që të përkrahet për diskutim në kuvend Informatë nga Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për muajt janar – prill 2026.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së rekomandojmë që kjo pikë e rendit të ditës të kaloj në shqyrtim në kuvend në seancën e radhës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, për këtë pikë besoj që ka me pasë debat të hapur, drejtoresha e ka marrë mundin të raportoj siç ka bë edhe më parë shpresoj se do na u përgjigjet në pyetjet tona për shumë sqarime andaj ne e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e vë në votim që kuvendit të komunës ti rekomandohet për diskutim Informata sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri, me 8 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim Informata sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Informatë nga Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë - DPKGJ

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti Informatën në fjalë, theksoi, sipas planit të punës si pikë e rendit të ditës së kuvendit kemi edhe raportin informues mbi ecurinë e punës nga DPKGJ për vitin 2025, kërkoj nga ana juaj që t'ia rekomandoni kuvendit për diskutim.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së e përkrahim dhe mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe e përgëzojmë drejtoreshën për këtë raportim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, raporti është shumë i mangët, është një raport i auditimit të pajtueshmërisë të cilin drejtoresha e ka dhe është dashur të na e sjellë me material e të na i tregoi gjetjet apo shkeljet e auditorit për punën e pronave që ka shumë, madje për 7 sosh ka treguar se çka duhet të veprohet e ju nuk e keni përfill por besoj që të gjitha këto në seancë do i diskutojmë një nga një andaj përgatitu mirë se unë këtë punën e pronave e kam goxha për shpirt e besoj se do i sqarojmë të gjitha një nga një andaj përgatitu mirë. Më vjen mirë që e keni sjellë prapë atë Shqipdon Rushitin se vetëm edhe këtu ka mbet pa qenë në komision edhe te fusha e futbollit isha te djali dhe e pash se i njëjti edhe aty ishte refer, goxha mirë kish përparuar ai, ish interesant ai.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e vë në votim Informatën sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes që Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri, me 8 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim Informata sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

5. Propozim vendim për ndryshim plotësimin e vendimit nr.prot.01-020/04-0019212/26 të datës 31.03.2026, Për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Njësia kadastrale; Lokali afarist me sipërfaqe 50m², dhe Lokali afarist me sipërfaqe 55m² të ndërtuara në Njësinë kadastrale P-71712062-00459-0 me sipërfaqe 2237m², Zona Kadastrale Podujevë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës besoi se sqarimet për këtë i dha më parë drejtoresha e DPKGJ-së.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nëse kish pas mundësi të na e lexoj arsyetimin do ishte shumë mirë se ne atë që ka dhënë dorëheqje prej komisionit nuk e kemi bërë me zor anëtare ose nëse ka ndonjë problem ta dimë, andaj nëse ka mundësi ta dimë arsyen e tërheqjes së saj.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, unë e kam kërkesën e saj që e ka paraqitur në drejtorinë tonë me arsyetim e këtë material do ua paraqes nesër secilit prej jush dhe do e shihni arsyen pse është tërhequr kjo anëtare e këtij komisioni.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim që t'i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri, me 8 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim propozim vendimi në fjalë.

6. Propozim plani i punës së KKSBB-së për vitin 2026

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, arsyetimin rreth kësaj pike të rendit të ditës e dha më parë drejtori z.Bahri Selimi, nëse dikush dëshiron fjalën urdhëroni.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, goxha mirë shohë por ky material qenka shkruar shumë keq me shkronja shumë të vogla, kjo duket si shaka, ky shkrim me shkronja shumë të vogla si me qenë lojëra të fëmijëve,

unë e lexoj edhe këtë shkrim kështu por të tjerët se di a munden prandaj le të merret parasysh që të rregullohet ky shkrim. Për mbledhjen e KKSB-së kisha pasë dëshirë të na e sillni listën e nënshkrimeve se në fotografi të faqes së komunës pash pak njerëz pjesëmarrës në atë takim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e vë në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim Propozim plani i punës së KKSB-së për vitin 2026.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 8 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim Propozim plani i punës së KKSB-së për vitin 2026.

Duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë rreth kësaj mbledhje, Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje, duke i njoftuar se Konstatimet e rekomanduara nga kjo mbledhje sot do të procedohen në Kuvendin e Komunës për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:27

**Procesverbalin e mbajti dhe hartoi;
Osman Bajrami**

**Nr.Prot.01-060/04-0030632/26
Podujevë,
26 maj 2026**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Isak Shabani**